



Bashkëfinancuar nga  
Bashkimi Evropian



# Monitorimi i prokurimit publik në nivel ministror dhe lokal

Gusht, 2024

- Ministria e Industrisë,  
Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Ministria e Mjedisit,  
Planifikimit Hapësinor dhe  
Infrastrukturës;
- Ministria e Punëve të  
Brendshme;
- Komuna e Pejës dhe
- Komuna e Gjilanit.







# QEVERISJE E MIRË

## AUTORË:

Egzona Kozhani & Ardit Dragusha



Vizitoni ueb faqen tonë  
[www.dplus.org](http://www.dplus.org)

Mësoni më shumë rreth publikimeve tona të fundit,  
lajmeve dhe infografikave online.



Na gjeni në Facebook  
[@democracyplus](https://www.facebook.com/democracyplus)



Na gjeni në LinkedIn  
[@democracy-plus](https://www.linkedin.com/company/democracy-plus)



Na gjeni në Twitter  
[@democracy\\_plus](https://twitter.com/democracy_plus)



Na gjeni në Youtube  
[@Democracy.Plus](https://www.youtube.com/Democracy.Plus)

## Zyret tona:

Rruga Bajram Kelmendi, Nr. 92, Kati V,  
Prishtinë, 10000  
Kosovë

+383 (0) 38 749 288  
[info@dplus.org](mailto:info@dplus.org)

**Deklaratë mohuese:** Ky raport është publikuar me mbështetje financiare të Bashkimit Evropian dhe SMART Balkans. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Demokraci Plus (D+) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe SMART Balkans. Projekti "Rritja e transparencës, llogaridhënies dhe eficiencës në shpenzimin e parasë publike përmes prokurimit publik në Kosovë" i financuar nga BE dhe SMART Balkans, zbatohet nga Demokraci Plus (D+).

# Tabela e përmbajtjes

Lista e shkurtesave .....	6
Hyrje .....	7
Metodologjia .....	8
Tender 1 - MINT - Sigurimi fizik për objektet e MINT-2 muaj - 204-23-9190-2-2-5.....	9
Tender 2 - MINT – Internship Biznesi 2023 – Ritenderim I - 204-23-9414-2-2-1.....	12
Tender 3 – MMPHI - Ritender - kontraktimi i një kompanie për rrënimin e objekteve pa leje dhe për nevojat tjera të inspektoratit të MMPHI-së - 210-23-9000-2-2-1.....	16
Tender 4 - Ministria e Infrastrukturës – Ndërtimi i rrugës Prizren - Kufiri me Maqedoninë e Veriut (Tetovë) - 205-23-11598-2-1-1 .....	20
Tender 5 - MPB – Furnizim emergjent me targa për regjistrim të automjeteve - 214-23-12148-1-1-5 .....	22
Tender 6 – MPB - Furnizim me licenca të Microsoft për IRK dhe edukim - 214-22-13725-1-1-5 .....	25
Tender 7 - MPB - Vazhdimi i punimeve AKADEMIA E DREJTËSISË AD -214-23-6442-5-1-1 .....	29
Tender 8 - Komuna e Gjilanit – Renovimi i stadiumit të Gjilanit - 651-23-13546-5-1-1.....	31
Tenderi 9 - Ndërtimi i objektit të ri të Gjimnazit Shkencor Bedri Pejani – 635-23-10843-5-1-1.....	34
Të gjeturat: .....	37
Rekomandimet:.....	38

# Lista e Shkurtesave

---

**AD** ➤ Akademia e Drejtësisë

---

**AK** ➤ Autoritet Kontraktues

---

**ATK** ➤ Administrata Tatimore e Kosovës

---

**DT** ➤ Dosja e Tenderit

---

**GOE** ➤ Grupi i Operatorëve Ekonomikë

---

**IRK** ➤ Institucionet e Republikës së Kosovës

---

**KIESA** ➤ Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë

---

**KRPP** ➤ Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

---

**MINT** ➤ Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

---

**MKRS** ➤ Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

---

**MMPHI** ➤ Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

---

**MPB** ➤ Ministria e Punëve të Brendshme

---

**OE** ➤ Operator Ekonomik

---

**OShP** ➤ Organi Shqyrtues i Prokurimit

---

**QVS** ➤ Qendra për Vlerësim dhe Standarde

---

**Sh.P.K** ➤ Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara

# Hyrje

Demokrasi Plus (D+) ka monitoruar prokurimin publik në nivel qendror dhe lokal, duke u fokusuar në gjashtë autoritetet kontraktuese: Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Komuna e Pejës dhe Komuna e Gjilanit. Këto autoritete kontraktuese sikurse organizatat tjera buxhetore, operojnë sipas Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) për të kontraktuar operatorë ekonomikë për punë, shërbime e furnizime, andaj edhe analizimi i tenderëve është bërë bazuar në këtë ligj dhe aktet nënligjore që dalin nga ky ligj.

Ky është raporti i parë i monitorimit të prokurimit publik për vitin 2024, i cili përfshinë periudhën e raportimit janar – qershor 2024.

Në raport janë të përfshirë nëntë tenderë të natyrave të ndryshme, me vlerë të përgjithshme të parashikuar të kontratave 72,751,258.09 euro.

Gjetjet e monitorimit tregojnë se institucionet publike vazhdojnë të lidhin kontrata një burimore duke mos arsyetuar përdorimin e kësaj procedure e cila eliminon konkurrencën mes operatorëve ekonomikë, vazhdojnë të shpërblejnë me kontrata operatorët ekonomikë që nuk i përmbushin kërkesat e vendosura në Dosje të Tenderëve si dhe bëjnë vlerësime të gabuara të cilat çojnë në vonesa dhe anulime të tenderëve.

# Metodologjia

Hulumtimi ka nisur nga përzgjedhja e aktiviteteve të prokurimit përmes platformës elektronike e-prokurimit.

Përzgjedhja është bazuar në disa indikatorë, si: vlera e parashikuar për tender, lënda që prokurohet, përsëritja e aktivitetit dhe procedura me të cilën zhvillohet aktiviteti i prokurimit, afatet kohore, çmimi i kontratës është shumë afër vlerës së parashikuar të kontratës, dhe çmimit jo normalisht të ulët.

Pas përzgjedhjes së tenderëve, D+ ka dërguar kërkesat për qasje në dokumente publike në ato autoritete kontraktuese që janë përzgjedhur për të qenë pjesë e raportit. Kërkesat për këto dokumente janë bazuar në ligjin për qasje në dokumente publike. Këto dokumente janë analizuar kundrejt rregullave të prokurimit publik përcaktuar me legjislacionin në këtë fushë.



## TENDER 1

# MINT - Sigurimi fizik për objektet e MINT-2 muaj - 204-23-9190-2-2-5

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), tash e disa vite me radhë kontraktin kompani për të ofruar shërbimin e sigurimit fizik për objektet e MINT.

Tri aktivitetet e fundit për kontraktimin e këtij shërbimi janë zhvilluar me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, dhe për tri aktivitetet kontratat janë lidhur me të njëjtin operator ekonomik, vlera e të cilave arrin në 75,723.00 euro.

**TABELA 1.** Tenderët për sigurimin fizik të objekteve të MINT të zhvilluar me procedurë të negociuar

Nr.	Lënda e prokurimit	Numri i prokurimit	Vlera e parashikuar (€)	Vlera e ofertave	Vlera e ofertave	Vlera e ofertave
1	Sigurimi fizik për objektet e MINT-së-2 muaj	204-23-9190-2-2-5	22,000.00	Defence Security Sh.P.K.	21,500.00	12.09.2023
2	Sigurimi fizik për objektet e MINT-së- për 2 muaj shtesë	204-23-12201-2-2-5	27,500.00	Defence Security Sh.P.K.	27,111.50	20.11.2023
3	Sigurimi fizik për objektet e MINT-it	204-24-122-2-2-5	27,111.50	Defence Security Sh.P.K.	27,111.50	01.03.2024

Aktiviteti që i ka paraprirë lidhjes së kontratës së parë të negociuar (kontrata e listuar në numër 1 në tabelën numër 1) ka qenë aktiviteti me numër të prokurimit 204-23-7170-2-1-1, për të cilin për kontratë ishte rekomanduar Rojet e Nderit Sh.P.K. me ofertën në vlerë prej 305,601.00 euro, mirëpo procedura kishte përfunduar në OShP<sup>1</sup>.

Ky aktivitet ka filluar me datë 14.07.2023 me publikimin e njoftimit për kontratë, ndërsa me 17.11.2023 ishte publikuar njoftimi për vendimin e autoritetit kontraktues. Sipas e-prokurimit, ende pa u marrë vendimi nga autoriteti kontraktues, MINT ka lidhur kontratë me të njëjtën lëndë (kontrata nr.1 në tabelën nr. 1), me procedurë të negoci-

<sup>1</sup> Ankesa në Organin Shqyrtues të Prokurimit me numër 972/23.

uar, pra ka zhvilluar dy procedura paralelisht. Një veprim i tillë paraqet shkeljen e parë lidhur me kontraktimin e këtij shërbimi. Përveç se janë shpërfillur afatet kohore që kërkon procedura e hapur, bie në kundërshtim edhe me një nga parimet më të rëndësishme në prokurim publik që është ai i ekonomicitetit dhe efikasitetit, i cili i obligon të gjitha autoritetet kontraktuese që të sigurojnë se fondet publike dhe burimet publike përdoren në mënyrë ekonomike<sup>2</sup>. Në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet përdorim ekonomik i fondeve publike nëse për të njëjtën lëndë të prokurimit, brenda të njëjtit vit, zhvillohen tri procedura paralele.

Shkelja tjetër është përdorimi i procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, duke mos u përbushur kushtet e parapara me LPP. Në këtë rast nuk kemi pasur të bëjmë me ndonjë të drejtë ekskluzive apo me ndonjë emergjencë ekstreme të shkaktuar nga ngjarje që nuk kanë mundur të parashikohen<sup>3</sup>, andaj edhe përdorimi i procedurës së tillë paraqet keqpërdorim të këtyre dispozitave.

Pas përbushjes së kësaj kontrate, pra saktësisht pas dy muajve, MINT nxori vendimin për tenderin me procedurë të hapur (17.11.2023). Sipas këtij vendimi, me kontratë do të shpërblehej OE Rojet e Nderit Sh.P.K. me ofertë në vlerë prej 305,601.00 euro, ndërsa Defence Security Sh.P.K. të cilët kishin dorëzuar ofertën më të lirë (303,940.00 euro), u diskualifikua me arsyen se nuk kishte përbushur kërkesë për qarkullim financiar dhe nuk kishte dorëzuar kontratat me referenca. Ndërsa, tri ditë më vonë, pra me 20.11.2023 është nënshkruar kontrata tjetër me OE Defence Security Sh.P.K., për sigurim fizik të objekteve, në vlerë prej 27,111.50 euro. Sikurse në rastin paraprak edhe për këtë kontratë është përdorur procedura e negociuar, me qëllim të zgjatjes së kontratës edhe për dy muaj tjerë shtesë. Operatorin ekonomik që e shpalli të papërgjegjshëm në aktivitetin me procedurë të hapur, e shpërbleu me kontratën e dytë një burimore.

Kundër njoftimit për vendim të datës 17.11.2023, OE i pakënaqur, me datë 04/12/2023 ka paraqitur ankesë në OShP, kështu duke e pezulluar aktivitetin. Ndërsa, ende pa u marrë vendimi nga paneli shqyrtues i OShP-së, MINT, në janar të vitit 2024 sërish lidhi kontratë një burimore me të njëjtin operator ekonomik, pra Defence Security Sh.P.K. në vlerë prej 27,111.50 euro.

MINT, në mënyrë të kundërligjshme, në tri raste, ka lidhur kontrata një burimore me të njëjtin operator ekonomik, kur paralelisht ka qenë duke u zhvilluar aktiviteti i njëjtë me procedurë të hapur. Kështu duke u shpenzuar rreth 75,723.00 euro përmes procedurave që shmangin parimet themelore të prokurimit, në veçanti atë të transparencës dhe konkurrencës.

Pavarësisht se kemi të bëjmë me shërbimin e njëjtë dhe nevojat e ministrisë mbesin të njëjta si në rastin kur shërbimi kërkohet të kontraktohet me procedurë të hapur apo me procedurë të negociuar, dosja e tenderit ka ndryshuar nga ajo e procedurës së hapur në atë të negociuar.

Në dosjen e tenderit të aktivitetit të zhvilluar me procedurë të hapur është kërkuar që, ndër të tjera OE duhet të dëshmoj qarkullim jo më pak se 750,000.00 euro në tri vitet e fundit dhe të ketë kryer punë të ngjashme në vlerë 550,000.00 euro, në tri vitet e fundit dhe të njëjtat t'i dëshmojë me referenca.

Ndërsa, në aktivitetet e zhvilluara me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë këto kërkesa janë larguar. Në anën tjetër, kompania fituese e tri kontratave një burimore është kompani e cila është regjistruar në shkurt të vitit 2023, që nënkupton se nuk ka mundur të plotësoj kritere të tilla.

2 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/ L- 042 për Prokurimin Publik, neni 6.

3 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/ L- 042 për Prokurimin Publik, neni 35.

Përdorimi i procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë nuk do të thotë marrje e shërbimeve që nuk arrijnë vlerën për paranë, andaj këto kritere, nëse paraprakisht janë paraparë të nevojshme për të dëshmuar përshatshmërinë e OE-së, nuk është dashur të largohen në tërësi nga dosja e tenderit. Prandaj, një rast i tillë krijon dyshime për përshtatje të kushteve dhe kritereve.

Përdorimi i procedurës së negociuar për një aktivitet i cili do të duhej të pezullohej sepse lënda ndodhej në OShP dhe largimi i kërkesave nga dosja e tenderit, nuk janë problemet e vetme.

Aktiviteti "Sigurimi fizik për objektet e MINT" i zhvilluar me procedurë të hapur është shoqëruar me parregullsi. Siç është theksuar edhe më lartë, për këtë aktivitet është shpallur fitues OE Rojet e Nderit Sh.P.K. me ofertën në vlerë prej 305,601.00 euro. Oferta e operatorit ekonomik fitues duket të jetë shumë e ulët në krahasim me vlerën e parashikuar, e cila është 380,000.00 euro, pra rreth 75.000.00 euro më e ulët. Në raste të tilla ekzistojnë dy çështje që duhet parë, fillimisht nëse AK nuk ka bërë vlerësimin e duhur të çmimit të tregut duke e vendosur një vlerë shumë të lartë, ose e dyta, nëse OE fitues mund ta përmbushë kontratën me ofertën e dhënë. OShP për këtë rast vendosi në favor të AK-së, kështu që kontrata ju dha OE Rojet e Nderit Sh.P.K., mirëpo ky vendim duket se është marrë pa u analizuar mirë të gjitha faktet dhe provat.

Nga ana e AK-së, në mesin e të tjerave, kërkesë e domosdoshme ka qenë që OE të paguaj punëtorët 350.00 euro neto, ndërsa numri i punëtorëve/rojeve është kërkuar të jetë 28 punëtorë. Nëse paga neto për një punëtorë është 350.00 euro, atëherë paga bruto i bije të jetë 404.63 euro<sup>4</sup>, duke përfshirë edhe 19.27 euro nga 5% i shpenzimit për kontributin pensional që paguhet nga punëdhënësi. Nëse shpenzimi bruto për një punëtor është 404.63 euro për një muaj, atëherë për 28 punëtorë do të jetë 11,329.64 euro për një muaj. Ndërsa, nëse 11,329.64 euro është shpenzimi bruto për një muaj për 28 punëtorët, atëherë për 24 muaj, sa edhe zgjatë tenderi, shpenzimi së bashku me 18% TVSh për shërbim, do të jetë 320,855.40 euro.

Nëse vetëm shpenzimet për kompensim të punëtorëve për atë kohë sa angazhohen përmes këtij tenderi, janë 320,855.40 euro, pa llogaritur shpenzime të tjera, i bije që kompania fituese e cila ka ofertuar me 305,601.00 euro, nuk do të arrij t'i mbulojë as pagat e punëtorëve. Si rrjedhojë, nuk do të paguhet punëtorët sa është kërkuar minimumi ose nuk do të përfillen pagesa e tatimeve për punëtorët e angazhuar, ose edhe nuk do të angazhohen 28 punëtorë sa është kërkuar. Sepse me këtë shumë, kompania nuk do të arrijë t'i përmbushë kërkesat e ministrisë, e assesi nuk pritet të punoj me humbje.

Në këtë rast, AK përveç se nuk ka përfillur faktin se vlera e kontratës dallon rreth 75,000.00 euro nga vlera e parashikuar, e njëjta nuk ka përfillur as kërkesat e veta të cilat i përcaktuar në dosje të tenderit. Në këtë mënyrë ka shpërblyer me kontratë një operator ekonomik i cili nuk i përmbushë kërkesat obligative të cilat vet AK i ka vendosur në dosjen e tenderit dhe nuk do të arrij të ekzekutojë kontratën në përputhje me kushtet e përcaktuara.

---

<sup>4</sup> Administrata Tatimore e Kosovës. Llogaritja e pagës bruto/neto. <https://www.atk-ks.org/kalkulatori-i-pagave-nga-neto-ne-bruto/>. Sqarim: Përmes kësaj platforme paga bruto del 385.36 euro sepse 5% i obligimit të punëdhënësit për kontribute pensionale nuk llogaritet. Nëse vlerës 385.35 euro i shtojmë dhe këtë 5% që në këtë rast ka vlerë 19.27 euro, atëherë marrim shumën 404.62 euro. Vlera prej 19.27 euro llogaritet shpenzim i kompanisë, prandaj edhe futet në kalkulim.

## TENDER 2

# MINT – Internship Biznesi 2023 – Ritenderim I - 204-23-9414-2-2-1

Programi “Internship Biznesi 2023” realizohet nga Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), e cila funksionin në kuadër të MINT. Ndër të tjera, ky program ka për qëllim formësimin e kuadrove të reja dhe krijimin e mundësive për punësimin e të rinjve.

Për të funksionalizuar këtë program, MINT ka bërë thirrje publike për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme që të paraqesin nevojat e tyre për burime njerëzore në mënyrë që të bëhet shpërndarja e praktikantëve nëpër këto ndërmarrje. Njëkohësisht, në muajin korrik të vitit 2023, MINT ka bërë edhe thirrje publike për praktikantët që të aplikojnë në këtë program, ku planifikohej të angazhoheshin 100 praktikantë.

Përveç thirrjeve publike, MINT ka iniciuar katër aktivitete të prokurimit që lidhen direkt me realizimin e këtij programi. Tri aktivitete janë iniciuar në vitin 2023, ku vetëm një ka qenë i suksesshëm, ndërsa aktiviteti tjetër me të njëjtën lëndë të prokurimit është iniciuar dhe lidhur kontrata në vitin 2022<sup>5</sup>.

Në vitin 2023, në aktivitetin e suksesshëm, me kontratë u shpërblye OE Global Consulting & Development Associates Sh.P.K., në vlerë prej 89,200.00 euro.

Sipas dosjes së tenderit, operatori ekonomik i kontraktuar duhet të shërbej si ndërmjetësues në mes të ministrisë, praktikantëve dhe ndërmarrjeve. Më saktësisht do të kryej detyrat si në tabelën në vijim.

---

<sup>5</sup> Tenderi me numër të prokurimit 204-22-8049-2-2-1.

**TABELA 2.** Disa nga punët që operatori ekonomik do të kryej dhe çmimi që MINT do të paguaj për këto punë

Nr.	Përshkrimi	Sasia	Çmimi njësi	Totali
1	Harmonizimi i kërkesave të ndërmarrjeve me ato të praktikantëve si dhe sistemimi i tyre	100	5.00 €	500.00 €
2	Printimi, aranzhimi i nënshkrimit të marrëveshjeve trepalëshe (MINT/KIESA, praktíkanti dhe ndërmarrjet)	400	5.00 €	2,000.00 €
3	Përgatitja e listës së vijueshmërisë së praktikantëve, e cila i dorëzohet kompanive për të mbajtur evidencën	50	20.00 €	1,000.00 €
4	Përgatitja e një raporti detal lidhur me marrëveshjet trepalëshe dhe sistemimin e praktikantëve në ndërmarrje	1	100.00 €	100.00 €
5	Përgatitja e raportit për praktikantët që kanë përfunduar praktikën dhe realizimi i pagesave në vlerë prej 250.00 euro (bruto) që duhet të dëshmohet përmes bankës	100	250.00 €	25,000.00 €
6	Punimi dhe dizajnimi i certifikatave për praktikantë dhe mirënjohje për bizneset	150	3.00 €	450.00 €
7	Organizimi i ceremonisë së shpërndarjes së certifikatave	100	60.00 €	6,000.00 €
8	Përgatitja e raportit final të implementimit të projektit.	1	300.00 €	300.00 €

Përveç aktiviteteve të paraqitura në tabelën 2, operatori ekonomik ka pasur për detyrë të zhvillojë edhe disa aktivitete të tjera për të cilat në total do të shpenzoheshin 89,200.00 euro, aq sa ka qenë vlera e kontratës. Mirëpo, MINT nuk ka qenë shumë e qartë në përpilimin e kërkesave por as OE fituesi nuk ka arritur ta ekzekutoj kontratën sipas kushteve të përcaktuara paraprakisht. Ngjecjet me këtë tender kanë të bëjnë me disa çështje, siç janë:

- I. Në tri pozicione të paramasës ka vendosur dy shërbime në një çmim. Në tabelën 2 ky pozicion është vendosur në pikën pesë, i cili thotë se për një praktikant do të ketë pagesë 250.00 euro dhe brenda kësaj shume do të mbulohet edhe shpenzimi për përgatitjen e raportit për praktikantët që përfundojnë praktikën për muajin e caktuar. Duke pasur parasysh se praktikantët do të kenë kompensim mujor prej 250.00 euro bruto, atëherë nënkuptohet se shërbimi për përgatitje të raportit do të ofrohet falas nga kompania, sepse nuk ka ndonjë burim tjetër buxhetor për këtë shpenzim. Përveç faktit se AK duhet të shmangë situata që krijojnë konfuzione të tilla, një veprim si ky bie në kundërshtim me LPP-në sepse për artikujt, shërbimet, punët që tentohen të ofrohen falas, tenderi duhet të

refuzohet sepse veprime të tilla konsiderohet si të papranueshme<sup>6</sup> dhe bie në kundërshtim me parimin e objektivitetit dhe integritetit<sup>7</sup>. Për këtë çështje, MINT ka thënë se shuma prej 250.00 euro është vetëm për pagesën bruto të praktikantëve, dhe jo për shpenzime të tjera. Por nuk ka sqaruar se me cilin buxhet do të mbulohet shërbimi i përgatitjes së raporteve<sup>8</sup>.

II. Sipas raporteve të pagesave<sup>9</sup> shohim se kompania e kontraktuar Global Consulting & Development Associates Sh.P.K. ka kryer pagesa për praktikantët në tre muaj. Për kompaninë ka qenë obligim që të angazhoj 100 praktikantë, ndërsa sipas faturave të dorëzuara del të jenë angazhuar 30 të tillë, të njëjtit për tre muaj, më saktësisht, në muajin e parë pagesat janë kryer me 08.12.2023 për 31 praktikantë, në muajin e dytë pagesat janë kryer për 30 praktikantë me datë 22.12.2023 dhe në muajin e tretë nga kompania janë paguar 27 praktikantë me datë 31.01.2024. Angazhimi dhe pagesa për 100 praktikantët ka qenë e paraparë edhe në paramasë, ndërsa kompania ka dështuar të realizoj këtë kërkesë të kontratës.

Përveç se kompania nuk ka realizuar këtë obligim, as menaxheri i kontratës në raportet e tij nuk e ka evidentuar këtë problem pavarësisht se situata e njëjtë ka qenë për tre muaj. Në këtë rast është bërë shkëlja e kontratës së lidhur në mes të MINT dhe Global Consulting & Development Associates Sh.P.K., më saktësisht neni 11 i kontratës i cili e obligon ofruesin e shërbimeve që të kryej shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikatat e më të mira profesionale<sup>10</sup>. Por edhe menaxheri i kontratës nuk ka bërë raportimet lidhur me këtë mangësi pavarësisht se ai është përgjegjës në zbatim të kontratës sipas termave dhe kushteve të caktuara<sup>11</sup>. Lidhur me këtë çështje, MINT ka arsyetuar mos realizimin e kësaj kërkesë duke thënë se nuk ka pasur interesim nga praktikantët prandaj edhe janë angazhuar vetëm 31 praktikantë<sup>12</sup>. Kjo pikë paraqet dështim në realizimin të kontratës sepse kjo nënkupton se kjo kërkesë nuk është realizuar as 50%. Kjo do të duhej të ishte indikacion për MINT se kompania fituese nuk po ekzekuton kontratën sipas kushteve, dhe të ndërprejë këtë aktivitet duke mos krijuar dhe shpenzime të tjera sepse me këtë realizim nuk arrihet qëllimi i tenderit.

III. Përveç se nuk janë angazhuar aq praktikantë sa ka qenë kërkesa, ka edhe aktivitete me vlera shumë të larta dhe mospërputhje në mes të çmimit në faturë dhe atij në paramasë. Sipas faturave që MINT ka pranuar nga OE i kontraktuar, del të jenë tetë fatura<sup>13</sup> në vlerë rreth 31,077.00 euro. Kurse, për tre mujorin sa ka qenë kohëzgjatja e kontratës, do të duhej të shpenzoheshin 89,200.00 euro, pra është realizuar vetëm afërsisht 34% e kontratës apo kanë tepruar 58,123.00 euro. Kjo vë në dukje një problematikë të madhe që tregon papërgjegjësinë e MINT gjatë planifikimit të aktiviteteve të prokurimit, menaxhim të dobët të kontratave dhe keqmenaxhim të parasë publike. Në anën tjetër, kjo tregon edhe mungesën e seriozitetit që kanë operatorët ekonomikë ndaj kontratave publike sepse një kontratë e tillë nuk do të duhej të përfundonte me një realizim kaq të ulët, pavarësisht se në kushtet e veçanta të kontratës është paraparë që të zbriten pozicionet të cilat nuk realizohen. Sipas MINT, mungesa e interesimit nga praktikantët ka qenë arsyeja e ekzekutimit kaq të ulët të vlerës së kontratës.

Përveç kësaj, ka pasur pozicione që kanë pasur vlerë shumë të lartë, aspak realiste. P.sh. pozicioni nr. tre i paraqitur në tabelën 2, pra lista e pjesëmarrësve, e cila nënkupton vetëm një fletë e çfarëdo formati, me tabelë me hapësira ku evidentohet praktikanti, dita dhe koha e mbajtjes së praktikës, do të paguhet 20.00 euro. Ndërsa, lidhur me mospërputhjen e çmimeve të paguara me ato në paramasë kemi p.sh. pozicioni shtatë i paraqitur në tabelën nr. 2,

6 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, neni 40.16.

7 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, neni 4.3, pika d.

8 Përgjigje e ofruar nga MINT me datën 07.06.2024.

9 Dokumente të marra pas kërkesës për qasje në dokumente publike të paraqitur me datë 29.03.2024.

10 Kontrata e lidhur me datë 25.10.2023 në mes të MINT dhe Global Consulting % Development Associates Sh.P.K.

11 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, neni 70.23.

12 Përgjigje e ofruar nga MINT me datën 07.06.2024.

13 Fatura 1 – 11.12.2023/ nr. 8966; Fatura 2 – 11.12.2023/ nr. 8967; Fatura 3 – 22.12.2023/ nr. 9010; Fatura 4 – 22.12.2023/ nr. 9011; Fatura 5 – 12.02.2024/ nr. 9097; Fatura 6 – 12.02.2024/ nr. 9098; Fatura 7 – 12.02.2023/ nr. 9098; Fatura 8 – 12.04.2024/ nr. 9200.

organizimi i ceremonisë së shpërndarjes së certifikatave, e cila do të kushtonte 6,000.00 euro për 100 praktikantët që do të marrin pjesë. Ndërsa, sipas faturës nr. 9200 e datës 12.04.2024, del se për këtë pozicion OE ka shpenzuar 2,542.37 euro, pra ka shpenzuar për rreth 42 persona, ndërsa në muajin e fundit të praktikës ka pasur vetëm 27 praktikantë. Kjo mund të arsyetohet me faktin se ka pasur pjesëmarrës nga kompania apo edhe nga ministria, mirëpo shpenzimet për këto dy palë nuk kanë qenë të parapara sipas përshkrimit të çmimeve.

Të gjitha çështjet e listuara më lartë tregojnë se MINT nuk ka bërë kontraktim serioz dhe nuk ka pasur për qëllim aftësimin e të rinjve në fusha të caktuara. Ndërsa, në mungesë të raportimeve dhe në mungesë të seriozitetit të ministrisë edhe OE nuk ka bërë përpjekjet që të ekzekutoj kontratën sipas kushteve të parapara.

Kjo nuk ka qenë kontrata e vetme e MINT për këtë lëndë. Kontrata e njëjtë dhe me të njëjtin operator ekonomik është lidhur edhe në vitin 2022, në vlerë prej 68,410.00 euro, apo për 20,790.00 euro më pak<sup>14</sup>.

---

14 Aktiviteti me numër të prokurimit 204-22-8049-2-2-1.

## TENDER 3

# MMPHI - Ritender - kontraktimi i një kompanie për rrënimin e objekteve pa leje dhe për nevojat tjera të inspektoratit të MMPHI-së - 210-23-9000-2-2-1

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës (MMPHI) ka lidhur kontratë kornizë, me kohëzgjatje prej 36 muajsh, me grupin e operatorëve ekonomik GOE Company Murseli Sh.P.K. & Grand Construction Sh.P.K., për të kryer rrënimin e objekteve pa leje dhe për nevojat tjera të inspektoratit të ministrisë.

Meqenëse kemi të bëjmë me kontratë kornizë, OE të interesuar kanë ofertuar me çmim për njësi, ndërsa vlera totale e ekzekutimit të punimeve është deri në 30,000.00 euro, me devijimin e lejuar prej +-30% të vlerës totale të ekzekutimit të punimeve.

Për këtë tender kanë ofertuar katër kompani, ku GOE fitues kishin ofertuar me çmimin më të ulët.

**TABELA 3.** Kompanitë ofertuese në këtë tender dhe vlera e ofertave

Nr.	OE ofertues	Vlera e ofertës /çmimi për njësi
1	GOE Company Murseli Sh.P.K. & Grand Construction Sh.P.K.	289.00 €
2	Brahim S. Tahiri B.I.	656.00 €
3	A-Z Group Sh.P.K.	2,190.00 €
4	Dardaniaa Sh.P.K.	2,245.00 €



Nga këto oferta mund të shohim se kemi dallime shumë të mëdha në çmimet për njësi të ofruara nga kompanitë ofertuese, ku oferta e GOE fitues është shumëfish më e ulët edhe se oferta e dytë më e lirë. Në raste të tilla duhet që të eliminohet mundësia për tenderë jo-normalisht të ulët. Tenderi jo-normalisht i ulët i referohet tenderit që për AK-në duket si jo i besueshëm dhe mund të ketë ndikim negativ në implementim të kontratës.

Sipas rregullave të përcaktuara në prokurimin publik, për tu konsideruar një tender jo-normalisht i ulët duhet që të plotësohen tri kushte:

1. Të jenë dorëzuar të paktën tre oferta për tender;
2. Çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
3. Çmimi i ofruar të jetë më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët<sup>15</sup>.

Kushti i parë plotësohet sepse në këtë rast janë katër oferta për këtë tender. Kushti i dytë gjithashtu plotësohet ngase, fillimisht sipas raportit të vlerësimit të gjitha ofertat janë të përgjegjshme dhe çmimi prej 289.00 euro është më shumë se 30% më i ulët se mesatarja e tenderëve, kjo sepse:

$$289+656+2190+2245= 5380/4(\text{oferta}) = 1345$$

Pra, mesatarja e ofertave për këtë tender është 1,345.00 euro. Nëse oferta më e ulët është 289.00 euro dhe vlera mesatare është 1,345.00 euro, atëherë i bije se oferta më e ulët është për rreth 78% më e ulët se vlera mesatare e ofertave, sepse:

$$\frac{1345-289}{1345} = \frac{1056}{1345} = 0.7851 \times 100 = 78.5\%$$

Kushti i tretë gjithashtu plotësohet, ngase çmimi i ofertës më të ulët, pra 289.00 euro është më shumë se 10% më i ulët se çmimi i tenderit të dytë më të ulët, sepse:

$$\frac{656-289}{656} = \frac{367}{656} = 0.559 \times 100 = 55\%$$

Që do të thotë se çmimi më i ulët i ofertuar është rreth 55% më i ulët se çmimi i dytë më i ulët i ofertave.

Në këtë rast, AK do të duhej të bënte këtë kalkulim dhe të zhvillonte procedurat e parapara me ligj për rastet kur kemi të bëjmë me tender jo-normalisht të ulët. Në bazë të dokumentacionit të këtij aktiviteti<sup>16</sup>, nuk është zhvilluar asnjë procedurë inter-partes<sup>17</sup> me këtë operator për të shqyrtuar më tutje ofertën dhe mundësinë e të kontratës me këto çmime. AK është e obliguar që të kërkojë nga operatori ekonomik që të shpjegojë çmimin e ofruar në rastet kur plotësohen tri kushtet për çmimin jo-normalisht të ulët<sup>18</sup>. Pavarësisht obligimit, një procedurë e tillë nuk është zhvilluar kështu duke neglizhuar në tërësi përgjegjësitë e veta por edhe duke mos pasur parasysh mundësinë që një tender i tillë, me këto çmime, mund të mos jetë i zbatueshëm.

Fakti që kemi të bëjmë me çmime të jo-normalisht të ulëta e tregojnë edhe çmimet për pozicione të caktuara, duke i krahasuar katër ofertat e dorëzuara për këtë tender

15 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, neni 41.3.

16 Ofrimi i qasjes në dokumente publike, pas paraqitjes së kërkesës me datë 29.03.2024.

17 Term ligjor nga latinishtja që do të thotë "ndërmjet palëve".

18 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, neni 41.3.

**TABELA 4.** Çmimet e katër ofertuesve për pozicione të caktuara në paramasë

Nr. i pozicionit	Emërimi i pozicionit	Çmimi i dhënë nga GOE fitues për një orë pune	Çmimi i dhënë nga ofertuesi i dytë më e lirë për një orë pune	Çmimi i dhënë nga ofertuesi i tretë për një orë pune	Çmimi i dhënë nga ofertuesi i katërt për një orë pune	Totali
1	Punë me aparat saldues	1 €	20 €	75 €	50 €	500.00 €
2	Punë me pajisje për shpuarjen e vrimave (burmashine)	1 €	10 €	50 €	20 €	2,000.00 €
3	Punë me pajisje për nxjerrjen e ujit (pompë uji)	1 €	20 €	50 €	100 €	1,000.00 €
4	Punë me pajisje (HILT) për thyerjen e materialeve të forta	5 €	10 €	150 €	50 €	100.00 €
5	Specialist për instalime elektrike, ujit, ngrohjes, etj, për ndërprerjen e rrymës gjatë ekzekutimit	1 €	30 €	50 €	100 €	25,000.00 €
6	Vlerësimi i dëmeve mjedisore të shkaktuara nga veprimet ilegale	1 €	50 €	250 €	300 €	450.00 €

Siç edhe shihet nga oferta e GOE fitues, ka shumë pozicione që janë vendosur me çmimin një euro për një orë pune. Pra, fakti që kemi të bëjmë me çmime të ulëta mjafton të krahasohen vetëm me ofertën e dytë më të lirë dhe shohim se çmimet për punë të njëjta kanë dallime shumë të mëdha. Në këtë rast përveç se është shkelur LPP, janë shkelur edhe çështje të tjera të rregulluara me ligje siç është paga minimale si dhe pagesa e tatimeve për punëtorët që do të angazhohen për zbatimin e kësaj kontrate.

MMPHI përveç se ka kontraktuar një kompani e cila ka vendosur çmime jo-normalisht të ultë në ofertën e saj financiare, me qëllimin e vetëm që të dal ofertuesi më i lirë, ajo ka kontraktuar një kompani e cila nuk respekton dhe nuk vepron në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik.

Në këto raste, AK do të duhej të zhvillonte procedurën për të qartësuar çmimet e vendosura nga GOE fitues, nëse i njëjti nuk do të përgjigjej apo nuk do të arrinte të bindte AK-në se me këto vlera mund të përmbushë kontratën, atëherë AK do të duhej ta refuzonte ofertën e GOE-së në fjalë<sup>19</sup>.

Ky nuk ka qenë tenderi i vetëm që MMPHI ka lidhur për të njëjtën lëndë. Në vitin 2020, MMPHI lidhi kontratë me të njëjtin operator ekonomik, Company Murseli Sh.P.K., me çmimin për njësi 176.50 euro, ndërsa vlera totale e kontratës ishte 30,000.00 euro. Kjo kontratë ka qenë e planifikuar të përfundoj në muajin tetor të vitit 2023, pikërisht në këtë muaj edhe është lidhur kontrata e re, 04 tetor 2023.

---

<sup>19</sup> Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, neni 41.7 dhe 41.10.

## TENDER 4

# Ministria e Infrastrukturës - Ndërtimi i rrugës Prizren - Kufiri me Maqedoninë e Veriut (Tetovë) - 205-23-11598-2-1-1

Me datën 12 dhjetor 2023, Ministria e Infrastrukturës publikoi njoftimin për kontratë me titull “Ndërtimi i rrugës Prizren - Kufiri me Maqedoninë e Veriut (Tetovë), segmenti Struzhë - Kyçja në Auto-udhën Dr. Ibrahim Rugova në Prizren - Jug, L=20.350 km.; Loti 1 - L= 6+913.73 km; Loti 2 = L= 6+525.00 km; Loti 3 = L= 6+911.27 km”, kontratë e ndarë në lote me vlerë të parashikuar 35,000,000.00 euro.

Në lotin 2, Ministria e Infrastrukturës, me datën 08 shkurt 2024, kërkoi nga konzorciumi “Damastion Project” & “Companya Eskavatori” SH.P.K. & “B Famis” SH.P.K. & “Eskavatori MK” L.L.C., që më së largu deri me datën 12 shkurt 2024, t’i dorëzonin dëshmitë lidhur me kërkesat e përshtatshmërisë (vërtetimet nga ATK, Gjykata) dhe sigurimin e tenderit në origjinal, të cilat kërkohen për fituesin e tenderit.

Në njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues, Ministria e Infrastrukturës, rekomandoi për kontratë një ofertues tjetër pasi që kishte bërë një raport të dytë të vlerësimit. Në këtë raport, të rivlerësimit shkruan se në bazë të vendimeve të Sekretarit të Përgjithshëm me nr. të protokollit nr.2012, komisioni për rivlerësim të ofertave pas ekzaminimit, krahasimit, vlerësimit dhe sqarimeve të ofertave, rekomandoi për kontratë grupin e operatorëve ekonomikë “Pricom” SH.P.K. & “Metag Insaat Ticaret” A.S. & “FS C ING” SH.P.K. & “Jaha Solar” SH.P.K.,

Në bazë të Rregullores së Prokurimit Publik, vendimi përfundimtar mbi dhënien e kontratës mbetet përgjegjësi e Zyrtarit përgjegjës të Prokurimit. Zyrtari përgjegjës i prokurimit mund të pranojë rekomandimin e komisionit apo refuzojë atë. Kur refuzohet rekomandimi i komisionit, Zyrtari përgjegjës Prokurimit do të shpjegojë arsyet me shkrim. Në situata të tilla Zyrtari përgjegjës i prokurimit mund të nxjerr vendimin përfundimtar ose mund të formoj komision të ri për ri-vlerësim. Shpjegim i tillë do të përfshihet në procesverbalin e aktivitetit të prokurimit. ZKA i AK-së menjëherë do të informohet për këtë refuzim<sup>20</sup>.

Ndonëse zyrtari përgjegjës i prokurimit mund të aprovojë ose jo rekomandimin e komisionit vlerësues, LPP dhe legjislacioni sekondar nuk e njeh një përgjegjësi të tillë sekretarit apo asnjë zyrtari tjetër të institucionit publik, ndaj vendimi nr. 2012, i përmendur në raportin e rivlerësimit paraqet shkelje procedurale dhe ndërhyrje në përgjegjësitë të cilat janë ekskluzive të zyrtarit përgjegjës të prokurimit.

20 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Neni 39.11.

Ndaj vendimit të Ministrisë së Infrastrukturës, konzorciumi që në vlerësimin e parë ishte rekomanduar për kontratë paraqiti kërkesë për rishqyrtim, të cilën ministria e refuzoi duke mos i shqyrtuar dhe arsyetuar asnjërin nga dhjetë (10), pretendimet e ngritura.

Me këtë rast, Ministria e Infrastrukturës, si autoritet kontraktues shkeli dispozitat e LPP-së<sup>21</sup>, që theksojnë se vendimet e miratuara duhet të jetë të arsyetuara dhe të ju komunikohen me shkrim parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, në qoftë se ka palë të tilla.

Konzorciumi që paraqiti kërkesën për ri-shqyrtim, bëri edhe një kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, duke kërkuar qasje në dëshmitë e përshtatshmërisë të ofertuesit i cili u shpall fitues e cila u refuzua nga ana e autoritetit kontraktues. Autoriteti kontraktues, me rastin e parashtrimit të kërkesës për qasje në dokumente publike, është i obliguar që të ofrojë qasje për çdo palë të interesit, duke kufizuar vetëm ato dokumente për të cilat është bërë kërkesa e arsyetuar se janë sekret afarist, me kushtin që këto kërkesa të jenë pranuar si të tilla nga ana e autoritetit kontraktues. Kjo lëndë është apeluar përsëri në OShP.

---

21 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Neni 108/A.

## TENDER 5

# MPB - Furnizim emergjent me targa për regjistrim të automjeteve - 214-23-12148-1-1-5

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) tash e disa vite me radhë lidhë kontrata me procedurë të hapur dhe me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, për t'u furnizuar me targa për regjistrim të automjeteve. Nga viti 2018 deri në vitin 2023, janë zhvilluar gjashtë aktivitete të prokurimit, dy prej tyre janë zhvilluar me procedurë të hapur, ndërsa katër me procedurë të negociuar. Mirëpo, ajo çfarë bije në sy lidhur me këto kontrata është se për të gjashtin vit me radhë, për të njëjtin aktivitet shpallen fitues të njëjtit operatorë ekonomik ku në total vlera e kontratave që MPB ka lidhur me këta operator ekonomik kap vlerën prej rreth 5,364,148.42 euro.

■ **TABELA 5.** Aktivitetet e prokurimit për furnizimin me targa, vlera e kontratës dhe operatori ekonomik fitues i të gjitha këtyre kontratave.

Nr.	Lënda e prokurimit	Nr. i prokurimit	Vlera e parashikuar	OE fitues	Vlera e kontratës	Data e lldhjes së kontratës
1	Furnizim me targa për regjistrimin e automjeteve	214-22-12927-1-1-1	2,632,297.70	GOE G.S.G Sh.P.K. & KIG d.d.	2,144,204.00	05.06.2024
2	Furnizim emergjent me targa për regjistrim të automjeteve	214-23-12148-1-1-5	315,600.00	G.S.G. Sh.P.K. & KIG d.d. & KIG KGA d.o.o.	273,000.00	08.12.2023
3	Furnizim me targa për regjistrimin e automjeteve- Ritender	214-18-9663-1-1-1	1,685,009.28	GOE G.S.G. Sh.P.K. & KIG d.d. & KIG KGA d.o.o.	1,447,714.00	04.02.2021
4	Furnizim emergjent me targa per regjistrim te automjeteve	214-20-746-1-1-5	339,541.24	GOE G.S.G. Sh.P.K. & KIG d.d. & KIG KGA d.o.o.	338 172,48	10.06.2020
5	Furnizim emergjent me targa të automjeteve	214-19-5566-1-1-5	144,700.20	GOE G.S.G. Sh.P.K. & KIG d.d. & KIG KGA d.o.o	137.545,58	07.08.2019
6	Furnizim emergjent me targa të automjeteve	214-19-8348-1-1-5	247,000.00	GOE G.S.G. Sh.P.K. & KIG d.d. & KIG KGA d.o.o	246.620,00	22.11.2019

Dy procedurat e hapura kanë përfunduar në OShP, ku për secilin aktivitet të zhvilluar me procedurë të hapur ka pasur nga nëntë ankesa. Pavarësisht se ankesat janë aprovuar si të bazuara nga OShP, ky i fundit sërish i ka dhënë të drejtë AK-së që të vazhdoj me vendimin e saj për shkak të stërzgjatjes së procesit<sup>22</sup>. Ky paraqet një vendim kontradiktor të panelit shqyrtues të OShP-së sepse nuk mund t'i jepet të drejtë edhe operatorit ekonomik ankues dhe autoritetit kontraktues ndaj të cilit paraqitet ankesa.

Pavarësisht se në disa ankesa, OShP ka kërkuar që të kthej lëndën në rivlerësim për shkak se janë aprovuar ankesat e operatorëve ekonomik, AK nuk ka përfillur një vendim të tillë dhe ka vazhduar të kontraktoj të njëjtin operator ekonomik, deri sa u detyrua edhe OShP të mos e kthej më lëndën në rivlerësim.

Aktiviteti i prokurimit numër një në tabelën 5, paraqet aktivitetin me të cilin është lidhur kontrata e fundit për këto furnizime. Ky aktivitet ka filluar në vitin 2022, mirëpo për shkak të ankesave të vazhdueshme në OShP, kontrata është lidhur pas dy viteve, pra në qershor të vitit 2024. Gjatë kohës sa ky aktivitet ka qenë në OShP, AK ka vepruar në kundërshtim me LPP-në, duke iniciuar aktivitet të ri me procedurë të negociuar për të njëjtën lëndë (aktiviteti numër dy në tabelë).

Paraqitja e ankesës në OShP e obligon AK-në që të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit, nëse nuk ka ndonjë vendim tjetër nga OShP<sup>23</sup>. Kjo nuk nënkupton se krijohet baza për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë. Për tu përdorur kjo procedurë duhet të plotësohen kushtet që dalin nga neni 35 i LPP-së.

Në arsyetimin e dërguar KRPP-së për përdorimin e procedurës së negociuar, AK veprimin e saj e ka mbështetur në nenin 35.2.1 (i) i cili lejon kontraktimit përmes procedurës së negociuar nëse *“për arsye objektive dhe të detyrueshme teknike ose artistike, kontrata duhet t'i ipet një operatori ekonomik të caktuar”* dhe në nenin 35.2.1. (iii) i cili nen lejon dhënien e kontratës përmes procedurës së negociuar nëse *“janë shkaktuar emergjenca ekstreme nga ngjarje objektivisht të verifikueshme të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen me arsye nga autoriteti kontraktues... kjo dispozitë të mos mund të shfrytëzohet nëse rrethanat që e kanë krijuar situatën emergjente ekstreme mund t'u atribuohen veprimeve neglizhente ose të qëllimta ose lëshimeve të autoritetit kontraktues”*.

Fillimisht, dispozita e parë e përdorur si bazë ligjore nuk vlen për këtë rast, sepse nuk kemi të bëjmë me asnjë rrethanë të detyrueshme teknike apo artistike që kontrata t'i ipet një operatori ekonomik të caktuar. Kjo sepse kompania në fjalë nuk ka monopol e as ndonjë të drejtë ekskluzive në furnizimin me targa, fakti se kjo kompani ka bërë furnizime të tilla tash e disa vite nuk e bënë këtë rrethanë detyruese që AK të ftoj në negociata vetëm këtë kompani, pasur parasysh që në procedurë të hapur janë dorëzuar nëntë oferta apo kanë ofertuar 16 operatorë ekonomikë, disa si ofertues të vetëm e disa në konsorcium.

Ndërsa, as dispozita e dytë e përdorur si bazë ligjore nuk vlen, sepse paraqitja e ankesave në OShP dhe pezullimi i aktivitetit nuk paraqesin rrethana ekstreme e as nuk paraqesin ngjarje që nuk kanë mundur të parashikohen nga autoriteti kontraktues.

Në këtë rast, AK ka vepruar në kundërshtim me LPP, më saktësisht nenit 35 të LPP që parasheh rrethanat që duhet të ekzistojnë në mënyrë që të lejohet përdorimi i kësaj procedure. Nga tabela 5 shohim se ky nuk është rasti i parë që është përdorur kjo procedurë për tu furnizuar me targa, madje janë zhvilluar katër aktivitete të tilla ku është kontraktuar i njëjti grup i operatorëve ekonomik. Kjo e bënë edhe më pak të besueshme arsyetimin e AK-së lidhur me përdorimin e procedurës së negociuar.

22 Vendimi i OShP me numër 227/24.

23 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/ L- 042 për Prokurimin Publik, neni 112.1.

Përdorimi i procedurës së negociuar mundëson që të mos respektohen disa rregulla të përcaktuara me LPP, siç mund të jenë afatet e ndryshme kohore, mirëpo kërkon që parimet, kurdo që është e mundur të respektohen, si p.sh. parimi i konkurrencës dhe barazia në trajtim/jo-diskriminimi<sup>24</sup>. Rregullat e prokurimit publik kërkojnë që për të negociuar të ftohen operatorë ekonomikë të përshtatshëm dhe të mos ekzistojë qëllimi i diskriminimit kundër apo në të mirë të një operatori ekonomik<sup>25</sup>, por nuk e kufizon numrin e operatorëve ekonomikë që duhet të ftohen në procedurë, mirëpo për të siguruar konkurrencën preferohet të ftohen të paktën tre operatorë ekonomik në negociata. Rregullat lejojnë që negociatat të zhvillohen me një operator ekonomik kur ekziston vetëm një furnizues dhe kur nuk ka alternativë tjetër<sup>26</sup>. Pavarësisht se në vend të parë kjo procedurë nuk do të duhej të përdorej fare, në raste kur plotësohen kërkesat ligjore për përdorimin e procedurës së negociuar, AK çdo herë do të duhej të ftoj më shumë se një operator ekonomik, në raste të ngjashme si me këtë, kur ka edhe shumë furnizues të tjerë që mund të përmbushin kontratën. Në bazë të veprimeve që AK ka ndërmarrë, ngritën dyshimet për favorizim të kompanisë në fjalë, veprim i cili bie në kundërshtim me LPP.

Në dosjen e tenderit të aktivitetit të hapur, AK kishte kërkuar që për të qenë i përgjegjshëm, OE duhet të dëshmojë qarkullim vjetor 3,000,000.00 euro, kontrata të ngjashme në vlerë jo më pak se 500,000.00 euro, test raport nga laboratorit apo instituti i autorizuar në përputhje me ISO 7591, ka kërkuar kopjen e certifikatës valide të ISO 7591, kopje të certifikatës valide të ISO 9001, kopje të certifikatës valide ISO 14001 dhe kopje të certifikatës valide të ISO 27001.

Ndërsa, në dosjen e tenderit të procedura e negociuar nuk janë paraqitur këto kërkesa e as nuk janë kërkuar kopjet e certifikatave të ISO-ve të lartcekura. Në këtë rast është kërkuar që tabelat të dorëzohen sipas standardit ISO 7591/1982 dhe se kërkohet kualiteti sipas standardeve ISO 19001, 14001 dhe 27001, por nuk është kërkuar nga OE që të dëshmojë se i posedon dhe janë valide këto ISO, si rrjedhojë edhe nuk ka dorëzuar në ofertën e saj asnjë ISO por vetëm ka deklaruar se e plotëson këtë kërkesë. Kjo forcon dhe më shumë dyshimin se AK harton specifikat dhe vepron në favor të kompanisë në fjalë në mënyrë që e njëjta të shpërblehet me kontrata.

---

24 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/ L- 042 për Prokurimin Publik, neni 7.2.

25 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, neni 50.6.

26 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, neni 50.7.



## TENDER 6

# MPB - Furnizim me licenca të Microsoft për IRK dhe edukim - 214-22-13725-1-1-5

Me 30 mars 2023, MPB publikoi njoftimin për nënshkrimin e kontratës për furnizim me licenca të Microsoftit për IRK dhe edukim në vlerë 14,988,509.87 euro, apo 99.9% e vlerës së parashikuar të kontratës.

Për këtë aktivitet të prokurimit, MPB përdori procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, duke ftuar vetëm një kompani për ofertim, me të cilin edhe nënshkroi kontratë. Në njoftimin e dërguar për KRPP, MPB arsyetoi përdorimin e kësaj procedure e cila kufizon konkurrencën e lirë mes operatorëve ekonomikë me faktin se ky aktivitet i iniciuar për herë të parë me procedurë të hapur, ishte anuluar në vitin 2022 dhe se ri-inicimi përmes procedurës së hapur “mund të prodhonte situatë të njëjtë sikurse aktiviteti i anuluar duke mos garantuar lidhjen e kontratës”.

Si arsye të dytë për kufizimin e konkurrencës, MPB kishte thënë se ekzistojnë vetëm dy furnizues/partner të Microsoft të autorizuar për Republikën e Kosovës si Licensing Solution Provider (ofruer të zgjidhjeve për licencim), njëra me bazë në Shqipëri (InfoSoft System) dhe tjetra me bazë në Serbi (Komtrejd Distribucija DOOEL). Në njoftim thuhej se “duke pas parasysh rrethanat që janë krijuar viteve të fundit në mes të dy shteteve Kosovë – Serbi, duke pasur parasysh që operatori ekonomik përveç furnizimit me softuer të licencuar do të ofrojë edhe përkrahje teknike në zgjidhjen e problemeve për të cilat kërkohet qasje në sisteme të rëndësishme, që mund ta rrezikojë sigurinë nacionale të parashikuara sipas legjislacionit në fuqi, i rekomandojmë Divizionit të Prokurimit që për negociatat të ftohet InfoSoft System si furnizues/partner i Microsoft-it i autorizuar për Republikën e Kosovës si Licensing Solution Provider.

### Arsyetimi i parë për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë

Dështimi i parë i këtij aktiviteti të prokurimit publik, i përmendur si një nga dy arsyet për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, kishte ndodhur në prill të vitit 2022, me MPB që publikoi një vendim ku thuhej se “një dispozitë e LPP kërkonte anulimin e këtij aktiviteti”. Në informacionin shtesë në formularin për anulim, MPB nuk përmend asnjë dispozitë të veçantë të LPP-së që kërkonte anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, por këtë anulim e bazon në Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative, konkretisht nenin 135, të këtij ligji i cili flet për afatin e zgjidhjes së ankesës administrative<sup>27</sup>.

<sup>27</sup> Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

LPP parasheh disa arsye mbi bazën e të cilave procedura e prokurimit mundet të anulohet pas hapjes së ofertave, por MPB nuk thirret në asnjërin nga to si dhe nuk paraqet arsytet faktike për një anulim të tillë, ndonëse kjo kërkohet me Rregulloren e Prokurimit Publik.<sup>28</sup>

Gjatë procedurës së hapur të këtij tenderi, që kishte vlerë të parashikuar të kontratës 12,000,000.00 euro, apo 3,000,000.00 më pak se në ri-tenderim, kishin ofertuar katër (4) kompani, me MPB që kishte rekomanduar për kontratë kompaninë Infosoft System Sh.P.K.

**TABELA 6.** Kompanitë ofertuese në tenderin e zhvilluar me procedurë të hapur dhe vlera e ofertave

Nr.	Emri i operatorëve ekonomikë	Vlera totale e ofertave
1.	Infosystem Sh.P.K.	10,295,243.94 euro
2.	GEO Komtrjd Distribucija DOOEL; Comtrade System Integration d.o.o	9,26,994.60 euro
3.	GEO Botek Sh.P.K., Semos d.o.o, King ICT DOO; King ICT dooel	11,564,088.44 euro
4.	Cactuss Sh.A	9,405,993.00 euro

Në lidhje me administrimin e këtij aktiviteti të prokurimit nga ana e MPB-së, ishin dorëzuar shtatë ankesa të ndryshme në OShP. Ky organ kishte vendosur në favor të dy operatorëve ekonomikë ankues (GEO Botek. dhe Cactus), duke anuluar njoftimin e dhënies së kontratës dhe duke e kthyer lëndën në rivlerësim, pasi kishte konstatuar se autoriteti kontraktues nuk kishte vepruar në harmoni me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe nenit 57 të LPP-së<sup>29</sup>.

Në rivlerësim, MPB përsëri kishte vendosur që me kontratë të shpërblehej operatori ekonomik Infosystem Sh.P.K., që po ashtu ishte apeluar nga dy operatorët ekonomikë si në herën e parë, por që këto ankesa ishin hedhur poshtë me datën 12.08.2022, si ankesa jashtë afatit për shqyrtim, për faktin se OShP kishte funksionuar pa bord deri në qershor të vitit 2022, ndaj nuk kishte mundur të bëjë vlerësim meritior mbi këto kërkesa brenda afateve ligjore.

LPP, konkretisht neni 35 i cili përcakton rastet se kur mund të përdoret procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, nuk parasheh asgjë në lidhje mbi vonesat potenciale apo anulimin e aktiviteteve të prokurimit për shkak të ankesave, ndërkohë shprehimisht parasheh që kjo dispozitë nuk mund të shfrytëzohet nëse rrethanat që kanë krijuar situatën emergjente ekstreme mund t'u atribuohen veprimeve neglizhente ose të qëllimta ose lëshimeve të autoritetit kontraktues. Në këtë rast, vonesa në lidhjen e kontratës së parë kishte ardhur pasi MPB kishte bërë vlerësim të gabuar, e vërtetuar me vendimin e OShP-së që kishte anuluar dhënien e kontratës duke e kthyer

<sup>28</sup> Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Neni 43. Pika 1. Në rast të vendimit të anulimit të procedurës së prokurimit, AK menjëherë do të përgatisë dhe do të publikoj Formularin B58 "Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues" ku paraqiten arsytet faktike dhe bazën ligjore të anulimit të tillë.

<sup>29</sup> Vendimi nr. 55/21 i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, i publikuar me datën 23.03.2021.

lëndën në rivlerësim, ndërkohë arsyetimi se ri-inicimi përmes procedurës së hapur do të mund të prodhonte një situatë të njëjtë sikurse aktiviteti i anuluar që kishte mbetur i bllokuar në OShP gjatë kohës sa ky organ nuk kishte bord, nuk qëndron pasi në momentin e hapjes së këtij tenderi, me datën 30.12.2022, bordi i ri i OShP-së kishte gjashtë muaj që kishte filluar punë, ndaj çdo ankesë eventuale do të mund të zgjidhej nga ky organ funksional sipas afateve ligjore.

### Arsyetimi i dytë për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë

Arsyetimi i dytë i dhënë nga MPB për kufizim të konkurrencës ka të bëjë me faktin që furnizues/partner të Microsoftit të autorizuar për Republikën e Kosovës si Licensing Solution Provider (LSP), janë vetëm dy kompani, njëra me bazë në Shqipëri (Infosoft System Sh.P.K) dhe tjetra me bazë në Serbi (Komtrejd Distribucija DOOEL).

LSP paraqet një autorizim nga Microsoft për të shitur softuer të licencuar për organizata të mesme dhe të mëdha<sup>30</sup>. Kjo kërkesë, në bazë edhe të së cilës MPB vendosi për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, nuk kishte qenë kërkesë në procedurën e hapur të këtij tenderi e cila ishte anuluar për shkak të vonesës në OShP. Në fakt, kërkesa mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale u ndryshua plotësisht, duke shtuar kërkesën LSP dhe duke larguar autorizimin nga prodhuesi për territorin e Kosovës si dhe dëshmitë për përfundimin me sukses të kontratave të ngjashme.

**TABELA 7.** Kompanitë ofertuese në tenderin e zhvilluar me procedurë të hapur dhe vlera e ofertave

Tenderi i parë me procedurë të hapur (2020)	Tenderi i dytë me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë (2022)
<p>1.Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të posedoj Autorizimit nga Prodhuesi (MAF) për territorin e Republikës së Kosovës për produktet të cilat janë pjesë e kësaj e kësaj kontrate.</p>	<p>Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të posedoj Autorizimit nga prodhuesi Microsoft për të ofruar produkte dhe shërbime sipas Microsoft Enterprise Agreement dhe Microsoft Enterprise Subscription Agreement. OE duhet te ketë status LSP (Licensing Solutions Partners) qe e mbulon Republikën e Kosovës për produktet qe janë pjesë e kësaj kontrate.</p>
<p>Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të ofrojë dëshmi së ka përfunduar me suksesa së paku tri (3) projekte të natyrës së ngjashme, nimumi njëri projekt të jetë i përfunduar (implementim) i licencave të Mictosoftit në fushën e edukimit nga (Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare).</p>	<p>N/A</p>

30 Licensing options for service providers. Gjetend në <https://www.microsoft.com/en-us/licensing/licensing-programs/spla-program>.

LPP i obligon autoritet kontraktuese që t'i trajtojnë në mënyrë të barabartë të gjithë operatorët ekonomikë teksa posaçërisht ju ndalohet të kërkojë nga operatori ekonomik që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose (ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos furnizojë ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik<sup>31</sup>.

Ndryshimi i këtij kriteri ka eliminuar konkurrencën e lirë të operatorëve ekonomikë, teksa është favorizuar vetëm operatori ekonomik Infosoft System Sh.P.K. Qëllimi i kriterëve teknike dhe profesionale është që të garantojnë një kualitet të caktuar por në asnjë mënyrë nuk duhet të përdorën që të eliminohet konkurrenca e lirë që çon në kontraktim të çmimeve më të lira.

Operatori ekonomik Cactus Sh.P.K., që kishte qenë përfituese e kontratës kornizë "Furnizim me licenca Microsoft" në dy raste të kaluara me MPB-në, në cilësinë e bashkëpunëtorit të operatorit ekonomik SoftwerON, që është partneri më i madh botëror dhe ka të drejtë për furnizim global LSP nga Microsoft, bëri kërkesë për rishqyrtim pranë MPB-së, me pretendimin se nuk është duke u respektuar barazia e operatorëve ekonomikë dhe se përdorimi i procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë ka pamundësuar konkurrencën e lirë dhe ka dëmtuar buxhetin publik për të paktën një milion euro.

MPB refuzoi kërkesën për rishqyrtim duke konstatuar se pretendimet e ngritura nuk ishin të bazuara, pasi nuk kishte asnjë dëshmi të vlefshme që operatori ekonomik "të kualifikohej si palë e interesit ashtu sikurse përkufizohet në nenin 4, paragraf 1.26 të LPP-së".

***"Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar".***

Në fakt, ky nen i ligjit nuk saktëson se si mund të dëshmohet interesi material, por duke qenë operator ekonomik i cili të paktën dy herë kishte lidhur kontratë për shërbimin e njëjtë me të njëjtin autoritet kontraktues, atëherë do duhej të kualifikohej si palë e interesuar.

---

31 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik. Neni 7, pika 5.

## TENDER 7

# MPB - Vazhdimi i punimeve AKADEMIA E DREJTËSISË AD - 214-23-6442-5-1-1

Në qershor të vitit 2023, MPB publikoi njoftimin për vazhdimin e punimeve në fazën e dytë të Qendra për Vlerësim dhe Standarde (QVS) – lot 1, dhe vazhdimin e punimeve në fazën e dytë të Akademia e Drejtësisë (AD) – lot 2.

Ky aktivitet i prokurimit kishte vlerë të parashikuar të kontratës 4,169,269.11 euro, dhe kohëzgjatje të punimeve 24 muaj nga dhënia e kontratës.

MPB, në cilësinë e autoritetit kontraktues me datën 19.10.2023, publikoi njoftimin për anulimin e lotit 2 për këtë aktivitet të prokurimit, vendim ky i cili u apelua nga dy operatorë ekonomikë, Astraplan Sh.P.K., dhe EBK Sh.P.K. Të dy kërkesat për rishqyrtim u refuzuan si të pabazuara nga ana e MPB-së, teksa të dytë këta operatorë ekonomikë dorëzuan ankesa në OShP.

OShP anuloi vendimin e MPB-së për anulim të aktivitetit, duke kthyer lëndën në rivlerësim, për faktin se autoriteti kontraktues, në arsyetimin e eliminimit për ofertuesin Astraplan Sh.P.K., si dhe në refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, nuk kishte potencuar në mënyrë të detajuar se cilët pjesë të ofertës nuk kishin plotësuar kriteret, si dhe nuk kishte argumentuar saktësisht arsyet e eliminimit.

Pas rikthimit të lëndës në rivlerësim, MPB shpërbleu me kontratë tenderuesin Astraplan, të cilin në vlerësimin e parë e kishte eliminuar se në listën e projekteve në lëmin e ndërtimit të lartë, vlera që ishte kërkuar në Dosjen e Tenderit kishte qenë 3,000.000.00 euro, ndërkohë ofertuesi kishte prezantuar projekte në vlerë 2,231,885.00 euro.

**TABELA 8.** Kompanitë ofertuese në këtë tender dhe vlera e ofertave

Nr.	Emri i operatorëve ekonomikë	Vlera totale e ofertave
1.	GEO EBK Sh.P.K & Pro Ark Construction Sh.P.K & N.P.N Univers MI	2,070,800.92 euro
2.	GEO Limit Project Sh.P.K., & Rinesa Sh.P.K.,	2,182,852.32 euro
3.	GEO Astraplan Sh.P.K., & u Unique Sh.P.K & Inet Sh.P.K	2,177,777.77 euro
4.	Nika Pro-Ing Sh.P.K., & Pro & Co Group Sh.P.K.,	2,168,903.73 euro
5.	GEO AC Ing Sh.P.K., & Top Projekt Sh.P.K., & Decon Sh.P.K	1,971,761.80 euro

Pas rikthimit të lëndës në rivlerësim, AK shpalli të papërgjegjshëm administrativisht GEO EBK Sh.P.K. et al., që kishte ofertuar me 106,976.85 euro më lirë se tenderuesi i rekomanduar për kontratë, me arsyetimin se nuk kishte vazhduar sigurimin e tenderit.

Për faktin se ky tender është vonuar pas kërkesave për rishqyrtim dhe ankesave në OShP, MPB është dashur që në mënyrë proaktive të kërkojë nga të gjithë operatorët ekonomikë që të bëjnë vazhdimin e validitetit të ofertave, përkatësisht vazhdimin e sigurimit të tenderëve.

Rregullorja e prokurimit publik parasheh që në situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkojë nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetit të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkojë para datës së skadimit dhe duhet të ngarkohet në sistem (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit). Në përputhje me rrethanat, nga të gjithë tenderët do të kërkojë që gjithashtu të zgjasin validitetin e sigurimit të tenderit të tyre<sup>32</sup>.

Anulimi i vendimit të MPB-së nga OShP dhe ankesa e përsëritur e operatorëve ekonomikë pas rivlerësimit kanë bërë që të mos fillojnë punimet në këtë projekt për më shumë se një vit nga dita e shpalljes së njoftimit për kontratë.

---

32 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Neni 30.4.

## TENDER 8

# Komuna e Gjilanit – Renovimi i stadiumit të Gjilanit - 651-23-13546-5-1-1

Komuna e Gjilanit me 8 dhjetor 2023 publikoi njoftimin për kontratë për renovimin e stadiumit të qytetit të Gjilanit, në vlerë të parashikuar të kontratës 15,000,000.00 euro. Ky aktivitet i prokurimit nuk ishte i përfshirë në planin përfundimtar vjetor të prokurimit të Komunës së Gjilanit, duke qenë se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), zhvilloi procedurat për hartimin e projektit dhe në bazë të një memorandumi të bashkëpunimit, MKRS-ja merrte përsipër sigurimin e mjeteve financiare në vlerën 15,000,000.00 euro, ndërkohë Komuna e Gjilanit do udhëhiqte të gjitha procedurat ligjore, përfshirë ato të prokurimit publik.

Për këtë projekt madhor, Komuna e Gjilanit, si autoritet kontraktues përdori procedurën e hapur teksa kriter i dhënies u caktua çmimi më i ulët.

Komuna e Gjilanit, si autoritet kontraktues, publikoi Dosjen e Tenderit, të cilin e ndryshoi me datë 29 dhjetor 2023, pas kërkesave për sqarim dhe rekomandimeve të KRPP. Mirëpo, edhe pas publikimit të versionit të korigjuar të Dosjes së Tenderit, u paraqitën ankesa nga operatorët ekonomikë në lidhje mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të kërkuara.

Për këto kriteret dhe aspekte tjera të Dosjes së Tenderit, operatorët ekonomikë “LimitProject Sh.P.K”, “Kuota Sh.P.K”, dhe “Pro & Co Group” Sh.P.K., paraqitën kërkesa individuale për rishqyrtim, të cilat u refuzuan së bashku me një vendim të Komunës së Gjilanit, të datës 12 janar 2024.

Në vendimin refuzues të Komunës së Gjilanit, u shkrua vetëm se autoriteti kontraktues kishte konstatuar se pretendimet e operatorëve ekonomikë ishin të pabazuara duke mos dhënë asnjë arsytim në lidhje me pretendimet e ngritura. Ky vendim i komunës është në shkelje të nenit 108/A të LPP, i cili thekson se refuzimi në kërkesat për rishqyrtim duhet të jetë i arsyetuar. Në këtë rast, autoriteti kontraktues përfshiu të gjitha pretendimet e operatorëve ekonomikë në një vend, dhe i refuzoi ato si pako duke mos ofruar arsytime për asnjërin nga to.

Autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të ju përgjigjen secilit operator ekonomik me vendim për secilin pretendim ankimor, duke dhënë përgjigje me shkrim në përputhje me ligjin për parashtruesit e ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara.

Komuna e Gjilanit, konkretisht Drejtoria për Kulturë dhe Sport, përpiloi disa kërkesa të cilat pas refuzimit të kërkesave për rishqyrtim, u apeluan në OShP. Konkretisht, te kapacitetet teknike dhe profesionale, AK kërkoi një udhëheqës të punishtes – inxhinier të diplomuar ose master i arkitekturës, i certifikuar me FIDIC dhe i certifikuar për auditim të energjisë në ndërtesa sipas standardit DIN EN 16247, me minimum pesë vite përvojë pune nga data e diplomimit.

Certifikata FIDIC është një program certifikues nga International Federation of Consulting Engineers (FIDIC)<sup>33</sup>, që është një organizatë globale që vendos standarde dhe udhëzime për inxhinierët këshillues. Ndonëse AK-të kanë të drejtë të vendosin specifikime teknike duke i'u referuar standardeve ndërkombëtare<sup>34</sup>, kërkesa që udhëheqës i punishtes të jetë i pajisur me këtë lloj të certifikatës, pa specifikuar llojin e programit kombinuar me faktin se personi i njëjtë, pra udhëheqësi i punishtes kërkohej të ishte i certifikuar edhe për auditim të energjisë në ndërtesa sipas standardit DIN EN 16247 paraqet kufizim të konkurrencës. Në fakt, AK nuk specifikoi se për cilin program të FIDIC bëhet fjalë pasi kjo organizatë ka pesë (5) lloje të certifikatave të cilat dallojnë njëra nga tjetra (gjyqtar i certifikuar, menaxher i certifikuar i kontratës, inxhinier konsulent i certifikuar, profesionist konsulent i certifikuar dhe trajner i certifikuar<sup>35</sup>), duke bërë praktikisht joefektiv kërkimin e këtij certifikimi.

OShP aprovoi pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik "Pro & Co Group" Sh.P.K., në lidhje me kapacitetet teknike dhe profesionale, duke konstatuar se kërkesa e vendosur nga Komuna e Gjilanit, që udhëheqësi i punishtes të ishte i certifikuar me dy standarde (FIDIC dhe DIN EN 16247), paraqiste kufizim të konkurrencës së lirë në treg dhe diskriminonte operatorët ekonomikë potencial që mund të aplikojnë në këtë aktivitet të prokurimit. OShP kërkoi nga autoriteti kontraktues që të largonte njëërën nga certifikatat e kërkuara nga Dosja e Tenderit. Në vendimin e OShP-së, përmendet edhe fakti se për këtë pikë të Dosjes së Tenderit, ishte tërhequr vërejtje edhe nga KRPP, pas monitorimit që i kishin bërë këtij aktiviteti të prokurimit.

Duke qenë se specifikat teknike nuk ishin hartuar në atë mënyrë që ato të ishin në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomikë, OShP vendosi ta kthej këtë aktivitet për përmirësim të Dosjes së Tenderit. Komuna e Gjilanit publikoi formularin standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara me datën 5 mars, 2024, tre muaj pas njoftimit të parë për kontratë.

Me përmirësimin e Dosjes së Tenderit, Komuna e Gjilanit, shtyu afatin e fundit për pranimin e tenderëve për datën 14 mars, apo nëntë ditë nga publikimi i këtij njoftimi. Rregullorja e Prokurimit Publik<sup>36</sup>, sqaron se ky afat duhet të zgjatet të paktën 10 ditë, për të i'u mundësuar operatorëve ekonomikë kohë të mjaftueshme për përgatitjen e ofertave kundrejt ndryshimeve në Dosjen e Tenderit.

Komuna e Gjilanit bëri edhe një tjetër shkelje të Rregullores së Prokurimit Publik, me rastin e publikimit të sqarimit të Dosjes së Tenderit, dokument i publikuar me datën 8 mars, me Rregulloren<sup>37</sup> që definon qartë se AK-të nuk duhet të zbulojnë identitetin e operatorit ekonomik që i ka kërkuar sqarime shtesë.

---

33 International Federation of Consulting Engineers. Mund të gjendet në <https://fidic.org/> (qasur për herë të fundit me 06.05.2024).

34 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Neni 5.

35 Programet FIDIC. Mund të gjendet në <https://fcl.fidic.org/programmes/> (qasur për herë të fundit me 06.05.2024).

36 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Neni 24.5.

37 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Neni 45.11.



Në këtë aktivitet të prokurimit, morën pjesë tre ofertues si grup të operatorëve ekonomikë:

**TABELA 9.** Ofertat e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë tender

<b>Nr.</b>	<b>Emri i operatorëve ekonomikë</b>	<b>Vlera totale e ofertës</b>
1.	GEO Pro & Co Group Sh.P.K.; Companya Eskavatori Sh.P.K.; Palma	14,404,578.30 euro
2.	GEO N.N.P. Euro Construction; Beni Construction Sh.P.K.; 2T Sh.P.K.; 2A Group Sh.P.K.; Domid Sh.P.K.;	13,274,752.02 euro
3.	GEO Demiri Gartenbau GmbH; El-Bau Sh.P.K.; Bujar Shabani B.I; Kosova Asphalt Sh.P.K.; K.N.T.Sh. Teuta – M Sh.P.K	14,997,804.00 euro

Procesverbal i hapjes së ofertave u publikua me 14 mars 2024, ndërkohë njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues, me anë të të cilit Komuna e Gjilanit rekomandoi për kontratë GEO Demiri Gartenbau GmbH; El-Bau Sh.P.K.; Bujar Shabani B.I; Kosova Asphalt Sh.P.K.; K.N.T.Sh. Teuta – M Sh.P.K, të cilët ofertuan me 14,997,804.00 euro, apo 99.98% e vlerës së parashikuar, u publikua me datën 31 maj 2024, apo 50 ditë punë nga dita e hapjes së ofertave.

Autoritetet kontraktuese obligohen që brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave, ta bëjnë publik njoftimin mbi vendimin. Kjo periudhë mund të zgjatet në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara për një afat shtesë prej 20 ditësh, por asnjë arsyetim i tillë nuk u publikua në njoftimin mbi vendim.

## TENDER 9

# Ndërtimi i objektit të ri të Gjimnazit Shkencor Bedri Pejani – 635-23-10843-5-1-1

Komuna e Pejës me 6 tetor 2023, në cilësinë e autoritetit kontraktues publikoi njoftimin për kontratë me titull “Ndërtimi i objektit të ri të gjimnazit shkencor Bedri Pejani – ritender”, në vlerë të parashikuar të kontratës 3,070,665.98 euro.

Në këtë aktivitet të prokurimit, Komuna e Pejës, përdori procedurën e hapur ndërkohë kriteri i dhënies u caktua tenderi me çmimin ekonomikisht më të favorshëm.

**TABELA 10.** Ofertat e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë tender

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlera totale e ofertës
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik DAJTING SH.P.K.; N.N.P. ATC COM SH.P.K	2,555,752.00 euro
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik AAG PROJEKT; Shkëmbi Sh.p.k.; Enggroup SH.P.K.; N.N.SH. WORLD MEDIUM,	2,981,010.38 euro
3.	Grup i Operatorëve Ekonomik „Raf II sh.p.k.; Benita Company	3,030,380.00 euro
4.	Grup i Operatorëve Ekonomik „Menti Sh.p.k.; Asfalti SH.P.K.	2.641.692.50 euro
5.	Olti Trasing SH.P.K.	2.640.000.00 euro

Me datën shtatë (7) dhjetor 2023, Komuna e Pejës, rekomandoi për dhënie të kontratës GEO “Dajting Sh.P.K., NNP AT Com Sh.P.K. Ky vendim i autoritetit kontraktues u apelua përmes kërkesës për rishqyrtim nga grupi i operatorëve ekonomikë AAG Projekt; Shkëmbi Sh.p.k.; Enggroup SH.P.K.; N.N.SH. World Medium.

Komuna e Pejës refuzoi këtë kërkesë për rishqyrtim, duke mos trajtuar pretendimet ankimore, me arsyetimin se kjo kërkesë ishte paraqitur vetëm nga lideri i këtij grupi të operatorëve ekonomikë, AAG Projekt, edhe e njëjta nuk është nënshkruar dhe vulosur nga të gjithë anëtarët e tjerë të grupit.

Në këtë rast, Komuna e Pejës dështoi në respektimin e Rregullores së Prokurimit Publik, e cila parasheh që anëtarët e grupit autorizojnë një partner udhëheqës të veproj në emër të grupit<sup>38</sup>. Duke qenë se AAG Projekt, ishte lider i grupit, AK dështoi edhe në trajtimin e pretendimeve ankimore, siç parashihet me Rregullore. Përveç arsyetimit të gabuar, mos trajtimit të pretendimeve ankimore, refuzimi i kërkesës për rishqyrtim nuk figuron askund në sistemin elektronik të prokurimit ndonëse një gjë e tillë është e obliguar me Rregullore.

**“Vendimi mbi refuzimin do të arsyetohet dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik nga Zyrtari Përgjegjës i prokurimit”<sup>39</sup>**

Operatori ekonomik AAG Projekt, si palë e pakënaqur, me vendimin e autoritetit kontraktues, ushtroi ankesë në OShP, me pretendimet e njëjta të cilat i kishte paraqitur në kërkesën për rishqyrtim, e cila ishte hedhur poshtë nga Komuna e Pejës.

OShP nuk vendosi për këtë ankesë, pasi të dyja palët, AAG Projekt dhe Komuna e Pejës, u pajtuan me raportin e vlerësimit të ekspertit shqyrtues, i cili rekomandonte që ankesa të aprovohej si e bazuar, të anulohet vendimi për dhënien e kontratës si dhe lënda të kthehej në rivlerësim<sup>40</sup>.

Ndonëse u pajtua me gjetjet e raportit të vlerësimit të ekspertit shqyrtues dhe ktheu lëndën në rivlerësim, Komuna e Pejës, me datën 9 shkurt, publikoi njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues, me anë të cilit rekomandohej përsëri për kontratë GEO,. Kundër këtij vendimi, operatori ekonomik AAG Projekt, paraqiti kërkesën për rishqyrtim, e cila përsëri u refuzua nga AK.

GEO i rekomanduar për kontratë në dy vlerësimet, Dajting Sh.P.K.; N.N.P. ATC Com Sh.P.K në ofertë kishte paraqitur dy marrëveshje të bashkëpunimit, me anë të së cilave ishte lidhur konzorciumi, ku bartës i projektit figuron fillimisht operatori ekonomik Dajting Sh.P.K., i cili autorizohet që të ishte partner udhëheqës i projektit, i cili do të nënshkruante të gjitha dokumentet në lidhje me tenderin. Ndërkohë, në deklaratën në mes të Dajting Sh.P.K., dhe ATC Com Sh.P.K., thuhej që palët pajtoheshin që bartës i projektit të ishte ATC Com Sh.P.K.

Për këtë çështje, gjatë rivlerësimit, Komuna e Pejës, kërkoi sqarimin e konzorciumit përmes Letrës Standarde për Sqarimin e Tenderit. Ky veprim i Komunës së Pejës, në këtë fazë është i ndaluar, pasi AK-të kanë të drejtën që me shkrim të kërkojnë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve, por asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk mund të kërkohej nga AK-të ose të ofrohet nga një tenderues<sup>41</sup>.

Në DT, te kapacitetet ekonomike dhe financiare, Komuna e Pejës kërkoi kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës, mjete të gatshme në llogari, apo limit kreditor, në vlerë 300,000.00 euro. Për këtë, kërkohet një dëshmi nga banka, jo më e vjetër se jashtë muaj, e cila dëshmon mjetet e gatshme në bankë, ose një linjë kreditore të aprovuar në vlerën e kërkuar.

Ofertuesi të cilin Komuna e Pejës e rekomandoi për kontratë, dorëzoi një dokument, në të cilin thuhej “Banka do të konsideroj mbështetjen financiare duke u bazuar në kapacitetet të tij financiare dhe nëse plotësohen kushtet e përcaktuara nga banka për financimin në fjalë”. Kjo deklaratë nuk përmbush kërkesat e përcaktuara nga vetë autoriteti kontraktues dhe e njëjta ishte gabim që të pranohej.

38 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Neni 26, pika c.

39 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Neni 62.2.

40 Vendimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit. Vendimi nr. 1032/23.

41 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/ L- 042 për Prokurimin Publik. Neni 59. Paragrafi 2.

Operatori ekonomik AAG Projekt, me datën 23 shkurt 2024, ushtroi përsëri ankesë në OShP, me pretendimet e njëjta, duke qenë se Komuna e Pejës ndonëse ishte pajtuar me raportin e vlerësimit të ekspertit shqyrtues gjatë ankesës së parë, përsëri kishte vendosur që të rekomandoj për kontratë GEO Dajting Sh.P.K.; N.N.P. ATC Com Sh.P.K, për të cilin eksperti shqyrtues kishte konstatuar se ishte i papërgjegjshëm.

Në lidhje me ankesën e dytë në OShP, paneli shqyrtues vendosi se Komuna e Pejës nuk kishte vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurim publik dhe kërkesat e Dosjes së Tenderit, të cilat vetë i kishte përpiluar, duke i dhënë të drejtë pretendimeve të operatorit ekonomik ankues AAG Projekt, dhe anuloi njoftimin për dhënien të kontratës.

Me datën 3 qershor 2024, Komuna e Pejës publikoi njoftimin për nënshkrimin e kontratës me operatorin ekonomik AAG Projekt, si tenderi me çmimin ekonomikisht më të favorshëm.

# Të gjeturat:

- 1** Pavarësisht se aktiviteti me procedurë të hapur ka qenë në OShP, MINT për të njëjtën lëndë ka zhvilluar procedurë të negociuar dhe ka kontraktuar operatorin ekonomik të cilin e kishte shpallur paraprakisht fitues në aktivitetin me procedurë të hapur.
- 2** MINT ka shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik i cili nuk përmbushë kërkesat e autoritetit kontraktues sepse ka ofertuar me çmimin më të ulët sesa që kërkohet për zbatimin e kontratës.
- 3** MINT ka dështuar në evidentimin e problemeve dhe menaxhimin e kontratës duke mos raportuar dhe duke mos marrë masa ndaj operatorit ekonomik i cili nuk ka arritur të përmbushë kontratën për tre muaj radhazi.
- 4** MMPHI ka kontraktuar operatorin ekonomik i cili ka ofertuar me çmime jo-normalisht të ulëta dhe për këtë çështje nuk ka kërkuar sqarime nga operatori ekonomik.
- 5** MPB për të gjashtin vit me radhë kontraktonte një grup të operatorëve ekonomik për të kryer furnizimin me targa, pavarësisht se në Kosovë ka shumë biznese që punojnë me alumin dhe grupi në fjalë nuk kanë asnjë të drejtë ekskluzive lidhur me këtë furnizim.
- 6** MPB nënshkroi kontratë një burimore në vlerë 14,988.509.87 euro, duke ftuar për negociim vetëm një operator ekonomik, duke eliminuar kështu konkurrencën e lirë mes operatorëve të tjerë ekonomikë.
- 7** Ministria e Infrastrukturës, formoi komision të rivlerësimit pas vendimit të sekretarit, duke shkelur LPP-në, pasi vendimi për komision të rivlerësimit mund të merret vetëm nga zyrtari përgjegjës i prokurimit.

# Rekomandimet:

- 1** MINT të mos zhvillojë dy procedura paralelisht për të njëjtën lëndë sepse veprime të tilla përveç se shkelin LPP ato edhe ndikojnë në dyfishim të punëve/shërbimeve/furnizimeve.
- 2** MINT të mos përdorë procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë nëse nuk përbushen kushtet ligjore të parapara me nenin 35 të LPP-së.
- 3** MMPHI duhet që çdo rast kur ka dyshime për çmime jo-normalisht të ulëta të zhvillojnë procedurën inter-partes dhe të sigurojë se kontrata mund të zbatohen me ato çmime.
- 4** MPB duhet të përdorë procedurën e hapur në mënyrë që të garantojë konkurrencën e lirë mes operatorëve ekonomikë.
- 5** Ministria e Infrastrukturës nuk duhet të krijojë komisione të rivlerësimit për procedurat e tenderimit me vendime të sekretarit, pasi kjo është përgjegjësi e zyrtarit përgjegjës të prokurimit.
- 6** Komuna e Gjilanit duhet që të arsyetojë dhe argumentojë vendimet në lidhje me kërkesat për rishqyrtim, duke u përgjigjur në të gjitha pretendimet e ngritura nga operatorët ekonomikë.



